



UNIVERSITETI "KADRI
ZEKA" UNIVERSITY GJILAN
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI"
UNIVERSITY
PRIZREN
Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren
www.uni-prizren.com tel: 0 29- 232 140



UNIVERSITETI "HAXHI
ZEKA" UNIVERSITY
PEJE
UÇK pa nr., 30000, Pejë, Kosovë
www.unhz.eu tel: 039421739

Programi i përbashkët master: **Qeverisja lokale dhe shoqëria demokratike**
SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik/ në tri universitetet partnere
Titulli i lëndës:	Metodologji e kërkimit shkencor
Niveli:	MA
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	3 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi
Detajet kontaktuese:	bajram.kosumi@uni-gjilan.net
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda ofron njohuri të avancuara nga fusha e hulumtimeve në shkencat shoqërore. Në kuadër të kësaj lënde ofrohen përmbajtje për metodat kuantitative dhe kualitative të hulumtimit.</p> <p>Gjithashtu, ofrohen përmbajtje që sqarojnë edhe qasjen mikste të hulumtimit (Trekëndëzimi hulumtues)</p> <p>Lënda ofron tema përkitazi me metodat kualitative të hulumtimit: metoda fokus grupit, studim rasti, intervista e pa-standardizuar, observimi, analiza e të dhënave sipas qasjes kualitative etj. Të gjitha këto metoda ilustrohen me shembuj praktikë.</p> <p>Lënda ofron edhe përmbajtje për organizimin konkret të një hulumtimi shkencor, fazat e tij dhe kapitujt kryesor të tij.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Të kuptojnë konceptet në fushën e hulumtimeve kualitative, të përgatiten për përdorimin efektiv të metodave kualitative të hulumtimit, të analizojnë të dhënat në formë kualitative, të zhvillojnë shkathtësi të studimit dhe shkrimit akademik.</p> <p>Përmes trajtimit të temave, zhvillohen shkathtësi të organizimit të hulumtimeve, përdorimit efikas të metodave kuantitative dhe kualitative, analizës së të dhënave dhe shkathtësi të shkrimit akademik.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> – Shpjegojnë konceptet në fushën e hulumtimeve; – Përvetësojnë metodat kuantitative dhe kualitative hulumtuese, si dhe metodave mikste; – Demonstrjnë shkathtësi të përdorimit praktik të metodave hulumtuese; – Prezantojnë projektin hulumtues për tezë të Masterit duke përdorur metoda kuantitative, kualitative dhe mikste;
Kontributi në ngarkesën e studentit	

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15/javë	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15/javë	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	2	4
Ushtrime në teren	5	1	5
Seminare/projekt propozimi për temën e masterit	4	3	12
Detyra të shtëpisë	1	13	13
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	14	28
Përgatitja përfundimtare për provim	3	3	9
Koha e kaluar në vlerësim të projekt-propozimit për temë të masterit	3	3	9
Projektet, prezantimet etj			
Totali	24		139

ECTS: 5.85

Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Leksion I avancuar, diskutime, punë në grupe, punë në çifte, punë individuale, metoda ndërvepruese të mësimdhënies</i>
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrja në mësim, angazhimet/detyrat: 10% Prezantimet nga hulumtimi: 10% Vlerësimi i projekt-propozimeve të temave të masterit: 30% Vlerësimi final: 50%
Literatura	
Literatura bazë:	1. Bob Matthews dhe Liz Ross (Universiteti i Birminghamit), <i>Metodat e hulumtimit/udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane</i> , CDE, (botimi origjinal: 2010) 2. Umberto Eko, <i>Si bëhet një punim diplome</i> , Përpjekja, 1997, Tiranë.
Literatura shtesë:	1. Ronald Czaja, Johnny Blair, <i>Hartimi i sondazheve/udhëzues për vendimet dhe procedurat</i> , Botimet Dudaj. 2. Sylvian Barnet, Pat Ballanca, Marcia Stubbs, <i>Shkrimi akademik</i> , ISP & Dita, 2000, Tiranë.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjëratat që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në metodat e hulumtimit në shkencat shoqërore. Çka është hulumtimi? Mendimi kritik.
Java e dytë:	Dijet, teoritë, paradigmat dhe këndvështrimet.
Java e tretë:	Natyra e burimeve dhe të dhënave. Pyetja e hulumtimit, hipoteza dhe përkufizimet operative të hulumtimit.
Java e katërt:	Përgatitja e hulumtimit. Planifikimi i projektit hulumtues. Pasqyra e literaturës. Skedat. Hyrja.

Java e pestë:	Modelet e hulumtimit. Metodatat cilësore, sasiore dhe të përziera. Trekëndëzimi. Zgjedhja e metodave.
Java e gjashtë:	Zgjedhja e kampionit. Propozimet e hulumtimit.
Java e shtatë:	Mbledhja e të dhënave. Shprehjet e mbledhjes së të dhënave.
Java e tetë:	Pyetësorët. Intervistat gjysmë të strukturuar.
Java e nëntë:	Grupet e fokusit. Vrojtimi. Të dhënat rrëfyese. Dokumentet. Burimet dytësore. Mbledhja e të dhënave me kompjuter.
Java e dhjetë:	Analiza e të dhënave. Analiza statistikore. Analiza tematike. Analiza e përmbajtjes.
Java e njëmbëdhjetë:	Përfundimet. Të shkruarit. Tipa të ndryshëm të hulumtimeve. Për kë shkruajmë?
Java e dymbëdhjetë:	Struktura e një punimi të masterit. Fusnotat. Literatura.
Java e trembëdhjetë:	Etika në hulumtimet shkencore
Java e katëmbëdhjetë:	Prezantimi i projekteve nga ana e studentëve
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezantimi i projekteve nga ana e studentëve
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<ul style="list-style-type: none"> - Secili studentë ka të drejtë të bëjë pyetje e komente sa herë që i jepet fjala; - Asnjëri nuk ka të drejtë t'i ndërhyjë tjetrit kur ai e ka fjalën; - Lejohet "zhurma" e punës kur studentët punojnë në grupe; - Nuk lejohet prishja e qetësisë kur ligjërohet nga mësimmshënësi apo prezantohet puna e studentëve; - Nuk lejohen telefonat celularë; - Nuk lejohet ardhja me vonesë apo dalja pa ndonjë arsye të qëndrueshme - Dënohet çdo formë e kopjimit apo falsifikimit 	